

Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02-03-23

Datë: 21. 03. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa në Junik, të mbajtur me datë 21 Mars, 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
3. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK),
4. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV), dhe
5. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK).

Poashtu, të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Nënkryetari Komunes, z. Besart Tofaj, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znjsh. Vjollca Qestaj, Drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis z. Zenun Shala, Drejtori për Shërbime Publike z. Demokrat Ganiqaj, Drejtoresha për Administratë znjsh. Leonora Shehu, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik znjsh. Gentiana Tofaj dhe Drejtori për Shëndetësi z. Fatos Shala.

Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, dhe ceku se të gjithë anëtarët e KPF-së janë të pranishëm në këtë mbledhje.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas kategorive,
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023,

4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektim rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimëror, ndriçimit publik dhe shërbimit të mbeturinave të amvisërisë në Komunën e Junikut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3, dhe P-73105038-00491-4, zona kadastrale e Junikut të shpallen zona me interes të përgjithshëm publik,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcela kadastrale me numër: P-73105038-00069-0, zona kadastrale e Junikut të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut, dhe
8. Të ndryshme.

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Ky procesverbal u shqyrtuan, ndërsa pati dy gabime teknike të cilat u kërkuar që të përmirësohen. Ky procesverbal me katër vota për, asnjë kundër dhe një abstenim u miratuan nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Dytë

Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas kategorive.

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, siç u tha kjo është kërkesë prej Drejtorisë për Buxhetit dhe Financa, ku kërkohet që të bëhet ndryshimi i buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve. Gjatë vitit 2022 është bërë tejkalmi i të hyrave vetanake, në mënyrë që këto të hyra të cilat janë tejkualuar për të mundur që ne t'i alokojmë dhe shpenzojmë në vitin 2023, po kërkojmë që të bëhet ndryshimi i planit për të hyrat vetanake për vitin 2022.

Në tabelë janë të prezantuara planifikimet dhe realizmi vjetor për 2022, ku mund të vëreni se kemi tejkalm të të hyrave për 47,611.94€. Shuma totale e të hyrave që janë inkasuar në periudhën Janar-Dhjetor 2022 duke përfshirë dhe të hyrat e bartura në muajin Gusht janë gjithsej 348,369.13€. Shuma e planifikuar për vitin 2022 ka qenë 159,038.00€. Gjatë vitit 2022 është bërë ndryshimi i këtij plani, janë bartë 141,719.19€, të hyra këto të inkasuara dhe të bartura për alokim për vitin 2022, dhe totali i planifikimit pas këtyre ndryshimeve ka arritur në 300,757.19€, ku ka një tejkalm të të hyrave për vitin 2022 për 47,611.94€. Këtu janë të përfshira edhe gjobat në trafik, por planifikimin e gjobave në trafik ne nuk e bëjmë pasi që kjo është kompetencë e nivelit qendror. Në mënyrë që këtë tejkalm prej 47,611.94€, që të mundemi ta alokojmë kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumën lartcekur. Pra, totali i të hyrave për vitin 2022 nga 300,757.19€ të rritet në total prej 348,369.13€, dhe ne kemi propozuar që kjo rritje të bartet si në vijim:

Në programin 48020 apo planifikimi dhe zhvillimi ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, të cilat mund të barten vetëm në shpenzimet kapitale, por edhe në kategoritë tjera. Pra, po kërkojmë që shuma prej 47,611.94€, të bartet në këtë program.

Kërkesa për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas kategorive, u miratua me pesë vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Tretë

Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023

Nënkryetari z. Besart Tofaj tha, në vitin 2022 ka qenë e planifikuar të inkasohen të hyrat vetanake në vlerë prej 159,000.00€, pastaj këto të hyra janë tejkaluar në vlerë prej 348,849.00€, ku prej tyre 91,915.00€ janë të bartura nga viti 2021 në 2022, duke përfshirë edhe të hyrat e bartura të cilat kanë arrit në vlerë 404,285.12€. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 janë shpenzuar 245,134.52€, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e pashpenzuar dhe ka vlerë 195,150.60€ kërkojmë që kjo bartje të bëhet për shpenzim në këto programe:

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale kërkojmë të barten 155,456.79€. Shuma prej 14,500.00€ të barten në kategorinë e shpenzimeve kapitale në projektin asfaltimi i rrugës lokale Junik-Jasiq në kategorinë e shërbimeve publike. Shuma prej 5,000.00€ të bartet në kategorinë ekonomike-shpenzime kapitale në projektin furnizim me gjenerator për objektin e Komunës në programin administrata. Kur jemi të kjo bartje duhet ta kemi parasysh se në buxhetin e Komunës kanë qenë të planifikuara 15,000.00€, shkaku i lëvizjes së çmimeve në treg duhet të shtohet edhe një shumë që të arrijmë ta blejmë gjeneratorin. Pastaj, kemi shumën tjetër prej 56,426.79€ të barten në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në kodin bashkëfinancimi i projekteve në programin zhvillimi ekonomik. Shuma prej 55,000.00€ të bartet në kategorinë e shpenzimeve kapitale për projektin e ri kanalizimi i ujërave të zeza në lokacionin Moronicë dhe Lagjen Krasniq. Në drejtorinë e urbanizmit shuma prej 20,000.00€ të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale për projektin e ri ndërtimi i mureve mbrojtëse të lokacionit Tofaj dhe Pepsh. Shuma prej 5,000.00€ të bartet me kategorinë ekonomike kapitale në projektin e ri, furnizim për analiza laboratorike në QKMF në programin shërbime të shëndetësisë primare, ndërsa të kategoria e mallrave kërkojmë që të barten 39,609.63€, ku prej tyre 30,609.63€ të barten në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime. Në drejtorinë e urbanizmit ku në kuadër të kësaj hynë hartimi i projektit të Qendrës, furnizimi me pajisje kompjuterike dhe hartimi i projekteve.

Shuma prej 5,000.00€ të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në drejtorinë e Shërbimeve Publike për vendosjen dhe mirëmbajtjen e kamerave të qytetit, dhe shuma prej 4,000.00€ të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në programin arsimit dhe shkenca, që synim është hartimi i projektit të fushës në Shkollën Filllore. Kategoria për subvencione në shumë 64.18€ kërkohej të bartet në kodin e njëjtë në kodin 113, pra në Zyrën e Kryetarit në kod 16020.

Z. Dervish Bajraktari pyeti, për asfaltimin e rrugës lokale Junik-Jasiq që janë ndarë 14,050.00€ për cilën pjesë bëhet fjalë?

Z. Besart Tofaj tha, bëhet fjalë për muret mbrojtëse që kanë qenë punë shtesë vitin e kaluar.

Z. Dervish Bajraktari pyeti për shumën prej 56,426.79€ bashkëfinancim i projekteve në nuk e dijmë se për cilat projekte bëhet fjalë, dhe shuma prej 30,609.68€ e bartur në kategorinë mallra dhe shërbime në programin planifikimi urbanizëm dhe mjedis, por nuk po e dijmë se ku po shkojnë, poashtu për gjenerator, dhe të arsimit 4,000.00€ fusha e sportit. Keni thënë se do të paguani 15,000.00€, a paska luajt çmimi tash, dhe ju thatë që duhet të shtohen edhe 5,000.00€?

Z. Besart Tofaj tha, tani po filloj të fusha e sportit në shumën prej 4,000.00€, këto nuk janë për ta bërë fushën e sportit por për të bërë projekte të fushës së sportit. Shuma prej 30,000.00€ është projekt i Qendrës 20,000.00€, është për pajisje elektrike për nevojat e drejtorisë 8,000.00€, dhe shuma tjetër është për hartim të projekteve.

Pyetja tjetër, të bashkëfinancimi i projekteve krahas asaj që tha drejtoresha që është 52,000.00€ që është bashkëfinancim i projektit, 47,000.00€ janë nga viti i kaluar, dhe kjo pjesa që bartet tash këtu, parashihet që mundet me pasë donatorë të mundshëm që pastaj ne të bashkëfinancojmë, por këto nuk janë projekte konkrete përveç kësaj që është e nënshkruar tek ura në Jasiq, pastaj varësisht prej rrethanave që na paraqitet ndonjë donator e kemi paraparë këtë pjesën tjetër.

Për rrugën Junik-Jasiq z. Demokrat Ganiqaj tha, kjo rrugë është asfaltuar vitin e kaluar por është paraqit nevoja për disa mure mbrojtëse dhe lëshesa të cilat kanë qenë të parapara me kontratë të vjetër, dhe ka qenë e detyrueshme që të finalizohet ajo pjesë, në mënyrë që të mos dëmtohen pronat. Atëherë ne kemi paraparë një kontratë të re për përfundimin e këtyre punëve që është në vlerë prej 14,600.00€, nëse nuk gaboj.

Tani këto janë bartë prej viti të kaluar në këtë vit për shkak se nuk kemi mundur që t'i kryejmë për shkak të motit dhe vërshimeve, janë kryer këtë vit.

Znjsh. Leonora Shehu tha, unë kisha mundur të japë përgjigje për gjenerator, kjo është kërkesë e drejtuar nga Administrata për bartje edhe të 5,000.00€. Sipas çmimeve të tregut dhe specifikave që ne po kërkojmë 15,000.00€ nuk janë të mjaftueshme, prandaj kemi kërkuar që të barten edhe 5,000.00€ shtesë për këtë projekt. Ne kemi gjeneratorin por ka defekte dhe kemi patur shumë probleme vitin e kaluar. Nuk ka pasë kontratë të mirëmbajtjes, me kontratë është dashtë t'i bëjmë servisim dhe mirëmbajtje, por gjeneratori është me defekt.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, nëse kontraktori oferton me vlerë të ulët, atëherë teprojnë para, por nëse është kostoja më e madhe se parashikimet, atëherë dështon si projekt. Dy gjera nuk më kanë pëlqyer te shpërndarja e këtyre mjeteve; njëra është shuma prej 64.18 € të Zyrës së Kryetarit, dhe tjetra çështja zërimit që vazhdimisht po e ngritim në Kuvend, por e cila nuk i shërben vetëm Kuvendit por edhe Komunës.

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, mund të vëreni që secila nga këto projekte që janë kërkuar që të barten këto mjete, janë mjete që janë në vazhdimësi dhe për shkak të rritjes së çmimeve të tregut për t'i mbyllur këto projekte e kemi parë të arsyeshme që t'i bartim këto mjete. Nuk është problem bartja e këtyre mjeteve për zërmë të Asamblesë, sepse edhe ne po funksionojmë aty, por këto kanë qenë projekte të filluara, dhe mjetet janë bartë me qellim që të përfundohen ato projekte.

Znj. Rajmonda Krasniqi tha, unë desha të kërkoj sqarim për projektin për analiza laboratorike në kuadër të shëndetësisë, nëse kjo mund të realizohet sipas shumës apo mjeteve të parapara për këtë?

Z. Fatos Shala tha, është fjala për një aparaturë për pasqyrat e gjakut, dhe sipas informatës që kemi është afërsisht ky çmim.

Z. Xhemë Tofaj kërkoj që këto projekte të reja të mos mbeten vetëm në letër por të përfundohen.

Kjo kërkesë e pikës së tretë e Rendit të Ditës u hodh në votim dhe me tri vota për, asnjë kundër, dhe dy abstenime u miratua nga KPF-ja.

Pika e Katërt

Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektim rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimëror, ndriçimit publik dhe shërbimit të mbeturinave të Amvisërisë në Komunën e Junikut

Fjalën e mori z. Demokrat Ganiqaj i cili tha, vitin e kaluar kemi nënshkruar një kontratë dy vjeçare për mirëmbajtjen dimërore për rrugët lokale në Komunën e Junikut.

Në këtë kontratë është përfshirë pastrimi i rrugës nga bora, hedhja e kripës dhe pastrimi i trotuareve. Për fat të mirë vitin e kaluar dhe këtë vit deri më tani nuk kemi patur reshje të borës, dhe nuk është paraqitur nevoja që as në zonën urbane as në pjesën e epërme malore të ketë ndërhyrje. Ne kemi dashtë të pastrojmë rrugën për bjeshkë, por në konsultim me Shoqatën e Bjeshkatarëve kjo nuk është rekomanduar, dhe e vetmja ndërhyrje ka qenë shpërndarja e kripës prej fshatit Jasiq deri në Gjocaj në ditët me temperatura të ulëta.

Sa i përket ndriçimi publik, mendoj se gjendja është mirë, rreth 95 % të rrugëve janë të mbuluar me ndriçim. Kemi patur një kontratë një vjeçare për mirëmbajtjen e ndriçimit publik që ka funksionuar shumë mirë.

Deri me tani është shtuar rrjeti i ndriçimit publik në rrugën e Kallavajit rruga Mataj, një pjesë në Qendër dhe lagjen Qok.

Planifikojmë që këtë vit ta përsërisim kontratën për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe të shtojmë ndriçimin publik përgjatë shtratit të lumit Erenik dhe funksionalizimin e ndriçimit publik aktual.

Sa i përket mirëmbajtjes verore veç është në procedurë të prokurimit kontrata për rehabilitimi të rrugëve lokal dhe mirëmbajtjen verore. Gjithashtu, vlen të cekët që në kuadër të rrugëve ka qenë edhe një kontratë e vogël për sinjalizimi vertikal dhe horizontal. Ne kemi paraparë që t'i shtojmë disa shenja të cilat janë të dëmtuara.

Kemi rekomandim prej policisë rrugore për zëvendësimin e këtyre shenjave që paraqesin rrezik në komunikacion.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave vazhdojmë me kompaninë regjionale "Ambienti", që është duke bërë mbledhjen e mbeturinave. Shërbimi është duke u ofruar 100 % në territorin e Komunës së Junikut, poashtu edhe inkasimi është afër 98 %, që bëhet nga amvisëritë dhe bizneset, ndërsa jemi në procedurë të hartimit të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

Pika e Pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3, dhe P-73105038-00491-4, Zona Kadastrale e Junikut të shpallen zona me interes të përgjithshëm publik

Lidhur me këtë pikë z. Zenun Shala tha, me datën 21 Shkurt kemi patur takim me AKP-në, e cila ka vlerësuar që të gjitha pronat që janë interes i Komunës duhet të paraqiten në Asamble, dhe pastaj t'i propozohen AKP-së, që të kthehen si prona të Komunës në afat deri me 15 Maj, 2023. Kështu që disa prona janë dal vitin e kaluar, disa edhe më përpara në Asamble. Ne kemi ardhur në përfundim se këto dy prona me dy pika të Rendit të Ditës të qiten për votimin e juaj në Asamble, në mënyrë që të kalojnë nga pronat e AKP-së në pronën e Komunës. Megjithatë është

në planin zhvillimor komunal si vend për zhvillimin e industrisë së lehtë, kjo është Fabrika e Konfeksionit. Me këtë propozim Kuvendi shpall me interes publik të Komunës së Junikut parcelat e lartpërmendura. Pra, këto janë prona të paluajtshme të cekura në pikën 1 me sipërfaqe të përgjithshme 1 ha 59 ari e 24 m², që evidentohet në emër të pasurisë shoqërore Industria e Bashkuar e Tekstilit “Emin Duraku” në Gjakovë. Komuna e Junikut do ta kompensoj në shumën prej 20 % të vlerës së pronës së likuiduar, e cila u kompensohet punëtorëve të kësaj ndërmarrje sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtori z. Zenun Shala shpjegoj arsyetimin e shpronësimit të këtyre pronave, ndërsa kërkoj që kjo të kalon në KPF dhe në Kuvend, për arsye se është në interes të Komunës së Junikut.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi pyeti për objektin e fabrikës se çka ndodh me të, sepse kërkesa është vetëm për shpronësim të pronës?

Z. Zenun Shala tha, Komuna aplikon në Ministrinë e Financave, në Departamentin për Likuidimin, të cilët formojnë komision për vlerësimin e pronës, dhe në bazë të vlerësimit të pronës në paguajmë 20% të vlerës për punëtorë, pra vlerësohet edhe prona edhe objekti.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë **kërkesë** e cila me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Gjashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja qa parcela kadastrale me numër: P-73105038-00069-0, Zona Kadastrale e Junikut të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik

Edhe për këtë pikë z. Zenun Shala tha, propozimi është afërsisht i njëjtë. Kjo pronë është te Livadhi i Madh, ku është edhe Shtëpia e Bjeshkatarëve e ndërtuar në të, e cila poashtu është pronë e AKP-së, por e cila është edhe në Parkun Nacional. Si arsyetim është se kjo është qendër për rekreacion dhe turizëm, me sipërfaqe 2 ha, 8 ari e 69 m², si zonë kadastrale e Junikut, pronar e cilës është ndërmarrja ‘Gjeravica’ me bazë në Deçan, e cila është në menaxhim të AKP-së.

Me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim kjo **kërkesë** u miratua nga KPF-ja.

Pika e Shtatë

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, ne më herët në Kuvend kemi nxjerr një vendim që t’i lejohet DSHP-së të fillon punën me Draft-Rregulloren për Menaxhimi e Mbeturinave në Komunën e Juniku, pastaj në muajin Shkurt kemi miratuar Komisionin që të punon në këtë Rregullore, i cili e ka kryer punën e vet dhe e kanë dërguar në KPF për shqyrtim.

Fjalën e mori z. Demokrat Ganijaj i cili tha, desha ta bëj një sqarim, pasi që ne kemi marrë vendimin prej Kuvendit për themelimin e komisionit, ne kemi mbajtur një mbledhje të komisionit

dhe kemi shqyrtuar Rregulloren, dhe kemi patur disa vërejtje lidhur me kategorizim të kategorisë 5, që restorantet të barten nga kategoria 5 në kategorinë 4, dhe jemi pajtuar që me ato vërejtje të procedojmë në KPF, pastaj të vazhdoj në Kuvend, pra në lexim të parë, apo të dal në dëgjim publik, në mënyrë të merret vërejtët nga qytetarët, dhe biznese, dhe cilat kanë lidhje me Rregulloren, që të dëgjohen, përmirësohen, t'i ndryshojmë dhe t'i qesim në lexim të dytë në Kuvend.

Kjo rregullore është marrë nga GIZI, por është përshtatur për komunën tonë.


Në këtë rregullore hynë edhe kategorizimi i amvisërive dhe bizneseve, ku dihet se sa do të jetë tarifa për secilin biznes, ndërsa sa i përket amvisërisë kjo Rregullore përfshinë edhe diasporën, pra, banorët jo rezidentë, në mënyrë që ata të mos paguajnë njëjtë sikur banorët rezidentë. Unë kërkoj që kjo të kaloj nga KPF-ja në lexim të parë në Kuvend.

Kjo Draft-Rregullore u hodh në votim dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga KPF-ja.

Pika e Tetë Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime!

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KPF-së.


Gëzim Geci-Procesmbajtës

Shpejtim Gacaferi-Kryesues